



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KURBIN
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Laç, më _____.____.2022

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Rindërtimi dhe rikonstruksioni i 5 (pesë) qendrave shëndetësore në Bashkinë Kurbin, në kuadër të procesit të rindërtimit”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45000000-7 (Punë).

VLERA E FONDIT LIMIT: 258,669,600 (dyqind e pesëdhjetë e tetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind) lekë.

Ne mbështetje të Ligjit Nr.97/2019 “Per miratimin e Aktit Normativ, me fuqine e Ligjit,Nr.9,date 16.12.2019, te Keshillit te Ministrave, “Per perballimin e pasojave te fatkeqsise natyrore”, Vendimit Nr. 225, date 12.04.2021 “Per miratimin e dokumentave standarte te tenderit per mallra, pune, sherbime per procedure e prokurimit “Procedure e pershpejtuar”, për këtë procedurë prokurimi u përdorën dokumentat standarte të tenderit “Procedure e pershpejtuar-Rindertimi Pune” dhe konkretisht të llojit “Tender i kufizuar ne kuader te rindertimit” te miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik.

Afati i punimeve do te jete: 12 (dymbëdhjetë) muaj.

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 42 të Aktit Normativ.
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet përgjegjëse.

Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rasti se kemi grupe operatorësh ekonomikë, secili prej operatorëve duhet të dorëzojë vetdeklarimet, sipas kësaj Shtojce.

Në çdo rast, autoriteti përgjegjës ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim grup operatorësh ekonomikë, duhet te dorezohet:

Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Shënim: Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore sipas përcaktimit në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje.

***Kjo marreveshje kuader perfshin hartimin e projektit si dhe zbatimin e punimeve ndertimore, kjo bazuar në nenin 39 pika 1 shkronja b.II, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.**

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në VKM nr. 225 datë 12.04.2021 “Për një ndryshim në vendimin nr.199, datë 04.03.2020 “Për miratimin e dokumentave standarte” si dhe në nenin 39 pika 1 shkronja b. II, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Kurbin** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT PËR PROJEKTUESIN

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;
- b. Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 8;
- c. Deklaratë mbi përmbushjen e Kriterëve të Përgjithshme, sipas Shtojcës 10;
- ç. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojcës 11;
- d. Deklaratë mbi ndërtimet civile dhe industriale sipas aktit normative sipas Shtojcës 14;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe VKM nr. 225 datë 12.04.2021 “Për një ndryshim në vendimin nr.199, datë 04.03.2020 “Për miratimin e dokumentave standarte”.

1.1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

1.1.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kapaciteti Ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas shtojcës 10.

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1) të Kriterëve të Përgjithshme (*Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe si dhe

VKM nr. 225 datë 12.04.2021 “Për një ndryshim në vendimin nr.199, datë 04.03.2020 “Për miratimin e dokumentave standarte”.

2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 1,000,000 lekë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit (nen 40 % te vlerës që ka parashikuar/përlllogaritur AK per projektimin) për këtë procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pika 1.c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës (per projektimin), është nën kufirin e ulët monetar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e kërkuara, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: *“Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.*

2.2.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një dokument që verteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2022 (sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin 9632/2006 ” Per sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 43, nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

Meqenese operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 1,000,000 lekë.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të

plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit (nen 40 % te vlerës që ka parashikuar/përlllogaritur AK per projektimin) për këtë procedure si dhe bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 1,000,000 të vlerës së parashikuar/përlllogaritur nga AK per projektimin, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e parashikuar e kontrates (për projektimin) eshte nen kufirin e ulet monetar. Vlera per pune te ngajshme perben nje nivel te mjaftueshem pervoje duke patur parasysh objektin dhe vleren e kontrates (per projektimin).

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Licensë profesionale për Projektim, e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mëposhtme, (sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi) për këto kategori:

PROJEKTUES ARKITEKT

- a) Projektim arkitektonik për objekte civile - industriale-turistike-vepra arti në infrastrukturë.
- b-3) Objekte Spitalore
- c) Projektim interiere.

PROJEKTUES KONSTRUKTOR

- a) Objekte civile - industriale – turistike prej murature e skelet betonarme deri në 5 kate.
- d) Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse prej beton-arme, murature dhe metalike;

PROJEKTUES INSTALATOR

- a) Instalime hidrosanitare.

- b) Instalime termoteknik–ventilimi-kondicionimi si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme.
- c) Linja e rrjeta elektrike–telefonike–radiotelefoni– citofoni–sistem alarmi–televiziv etj. Për objekte civile, industriale, turistike.
- f- Projektim të sistemeve kundra zjarrit.
- g) projektim te sistemeve te monitorimit dhe automatizimit ne industri dhe ndertesa
- h- Projektimi i impianteve ngritëse e transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse etj.).
- j- Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access controll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit etj., për objektet civile e industriale.

PROJEKTUES GJEODET

- a) Rilevime inxhinierike
- b) Rilevime inxhinierike kadastrale

STUDIM GJEOLIGO INXHINIERIK - HIDROGJEOLOGJIK

- a) Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile – ekonomike deri 5 kate.
- d) Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve te buta dhe shpateve me qendrueshmeri te ulet .
- e) Studime e projektme hidrogjeologjike.

STUDIM TE SISMOLOGJISE INXHINIERIKE (vetem per shoqeri/subjekte juridike)

- a) Studim/vlerësim te sismologjise inxhinierike per klasifikim gjeosizmik te trojeve.
- b) Studim/vlerësim gjeologo-sizmike per trojet ku ndertohen objektet civile, sociale e kulturore.
- e) Studim/vlerësim te sismologjise inxhinierike per troje e shpate me qendrueshmeri te ulet dhe per troje ndertimore te shkrifta me mundesi lengezimi.

Në lidhje me vlefshmërinë e licencave ekzistuese dhe përshtatjen e kategorive me përshkrimet përkatëse, ofertuesit të mbajnë parasysht vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016”.

(Kandidati/Ofertuesi i huaj duhet të bëjë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë, të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Autoritetit shtetëror kompetent Shqiptar, konform VKM 759, date 12.11.2014, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016.)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i nryshuar, si dhe *vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016”.*

2.3.3 Operatori ekonomik (për projektuesin) duhet te ketë personelin kryesor, drejtues teknik të përfshirë në licencën e shoqërisë, vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, licensë profesionale per projektim, CV si dhe duhet te jetë ne Listëpagesat te paktën per periudhen Korrik – Shtator 2022 si më poshtë:

- 1 (nje) Arkitekt

- 1 (nje) Inxhinier Ndertimi
- 1 (nje) Inxhinier Hidroteknik
- 1(nje) Inxhinier Elektrik
- 1 (një) Inxhinier Gjeolog
- 1 (një) Inxhinier Mekanik
- 1 (nje) Inxhinier Gjeodet (Topograf/markshajder),

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe ligjin 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.4 Operatori ekonomik (për projektuesin) duhet te ketë staf mbeshtetes, vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë dhe/ose deshmit e kualifikimi (te vlefshme), te cilet duhet te figurojne ne listepagesat e shoqerise ose të kontraktuar, si më poshtë:

- 1 (nje) Inxhinier Ndërtimi, profili Strukturist
- 1 (një) Inxhinier Gjeolog me orientim gjeofizik
- 1(nje) Inxhinier IT/Telekomunikacion/Elektronik/Sistemesh
- 1(nje) Inxhinier Elektrik
- 1 (nje) Inxhinier Gjeodet (Topograf/markshajder),
- 1 (një) Auditues energjie i Çertifikuar nga Agjencia e për Eficencen e Energjise per te kryer auditime ne ndertesa dhe Instalime Industriale.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe ligjin 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- **1 (nje)** punonjes i pajisur me certifikatë si “Ekspert Privat Zjarrefikes” ne perputhje ma klauzolat e ligjit nr. 152/2015 date 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, shoqëruar me kontrate individuale pune te vlefshme, Diplome/certifikate si dhe duhet te figuroje ne listepagesat e shoqerise.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështet në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ligjin 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar, ligjin nr. 152/2015 date 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”. Eksperti zjarrefikës është i nevojshem për të arritur synimin, pasi referuar ligjir nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, roli i ekspertit zjarrefikës është në përpjesëtim me natyrën e kontratës.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim:

2.4.1 Certifikata që duhet te kete operatori ekonomik projektues:

- Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë mbi shërbime ekspertize dhe/ose profesionale të mbrojtjes civile, Kodi I.2.A.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.4.2. Ofertuesi duhet të ketë në pronësi ose me qera:

- *1(nje) Pajisje GPS*

Në lidhje me sa më sipër operatori ekonomik duhet të paraqesë: Fatura Tatimore shitblerje ose Kontratë shitblerje ose Kontratë Qiraje të noterizuar (origjinal).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

2.4.3 Operatori ekonomik projektues duhet paraqesë me anë të një deklaratë listën e personelit kryesor të nevojshëm që do të realizojë objektin e kontratës si dhe CV të shoqërisë për punët e realizuara gjatë aktivitetit të saj.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion punonjesit si dhe pune te ngjashme bindese për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT PER ZBATUESIN E PUNIMEVE.

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; (Kjo shtojce do paraqitet ne fazen e II)*

b. *Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 4;*

c. *Sigurim oferte sipas Shtojcës 5; Ofertuesit ose kandidatët e kualifikuar duhet të paraqesin sigurimin e ofertës, në vlerën 2% të vlerës së fondit / vlerës së përafërt të kontratës, të*

përcaktuar në dokumentet e tenderit, 5,173,392 (pesë milion e njëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e treqind e nëntëdhjetë e dy) Lekë.

ç. *Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*

d. *Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 8;*

dh. *Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojcës 11;*

e. *Formular vlerësimi sipas Shtojcës 12;*

f. *Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve/makinerive sipas Shtojcës 13;*

g. *Deklaratë mbi ndërtimet civile dhe industriale sipas aktit normative sipas Shtojcës 14;*

gj. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe VKM nr. 225 datë 12.04.2021 “Për një ndryshim në vendimin nr.199, datë 04.03.2020 “Për miratimin e dokumentave standarte”.

1.1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

1.1.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kapaciteti Ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas shtojcës 10.

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1) të Kriterëve të Përgjithshme (*Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe si dhe VKM nr. 225 datë 12.04.2021 “Për një ndryshim në vendimin nr.199, datë 04.03.2020 “Për miratimin e dokumentave standarte”.

2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më të vogël se vlera e fondit limit se përlllogaritur të kontratës ose lotit. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në raport me përqindjen (elementet konkrete) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e përlogaritur të kontratës të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019, 2020, 2021, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e kërkuara, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël,

së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet për vitin 2022 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 43, nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

Meqenese operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrorjnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së përllorëgatur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se fondi limit i kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

I) Për kontrata të realizuara me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vleresimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 12, shoqëruar me:
- Kontratë
- Situacionin përfundimtar;
- Aktin e kolaudimit;

Shënim: *Formulari i vleresimit duhet te percaktoje saktesisht cilesine e kryerjes se punes dhe faktin nese kontrata eshte realizuar me sukses.*

II) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 12, shoqëruar me:
- Kontrate
- Situacionin përfundimtar;
- Akt kolaudimi objekti;

Pika 2.3.1/a, *plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë:

- Kontraten e bashkimit te operatoreve te deklaruar ne fazen e tenderimit; Mos paraqitja e kontrates se kerkuar do te jete shkak skualifikimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vleren 25 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se fondi limit të kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e ulët monetar. Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj.

Vlera e kërkuar është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.2 Operoret ekonomike duhet te deshmojne se disponojne license profesionale per zbatim punimesh ne ndertim si dhe per kategorie e nevojshme per zbatimin e kontrates.

Per kete duhet te paraqesin licensen perkate se te shoqerise, bazuar neformatin e miratuar me Vendim te Keshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008; *Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi*”, i ndryshuar.

Licenca lidhur me ekzekutimin e punimeve:

- NP 1-A - Punime gjermimi në tokë
- NP 2-C - Ndërtime civile dhe industriale
- NP 3-B – Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile, e industriale, veshje fasade.
- NP 12-A - Punime të inxhinierisë së mjedisit
- NS 2-A – Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirembajtja e tyre.
- NS 4 –C - Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.
- NS 12-A – Impjante teknologjike, termikë dhe të kodicionimit.
- NS 14-B – Impjante te brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV etj.
- NS 18 –A – Punime topogjeodezike

Sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI/MEI apo Ministria kompetente e linjes ;

Shoqëritë e huaja duhet te kene kryer ekuivalentimin (njehsimin) e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastruktures, Republika e Shqipërisë, sic percaktohet ne Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM Nr.42, date 16.01.2008.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Kategoritë dhe nivelet e kerkuara jane vendosur ne perputhje me Vendimin Nr. 42 date 16.01.2008; *Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi*”, i ndryshuar.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1 A	Punime gjermimi në tokë			
NP 2-C	Ndërtime civile dhe industriale.			
NP 3-B	Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile,			

	e industriale, veshje fasade.			
NP 12-A	Punime të inxhinierisë së mjedisit			
NS 2-A	Impiante hidro- sanitare, kuzhina, lavanteri, mirembajtja e tyre			
NS 4-C	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese			
NS 12-A	Impjante teknologjike, termikë dhe të kodicionimit			
NS 14 - B	Impjante te brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV etj.			
NS 18 - A	Punime topogjeodezike.			

Shënim: Kjo procedure përfshin projektin dhe zbatimin e punimeve brenda fondit limit që Autoriteti Kontraktor ka prokuruar dhe pikat e licences janë vendosur sipas preventivit të llogaritjes paraprake të punimeve që mendohet të behen.

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik të përfshirë në licencën e shoqërisë**, si më poshtë:

- Inxhinier Ndertimi 2 (dy)
- Inxhinier Gjeodet 1 (nje)
- Inxhinier Mjedisi 1 (nje)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (nje)
- Inxhinier Mekanik 1 (nje)

- Inxhinier Elektrik 1 (nje)
- Arkitekt 1 (nje)

Secili prej pjesëtarëve të drejtuesve teknik të mësipërm, duhet të jetë në **Listëpagesat te pakten per periudhen Korrik – Shtator 2022** si dhe të figurojnë në **licensën e shoqërisë**.

Per secilin prej pjesëtarëve të stafit duhet të paraqitet:

- **kontratë pune e vlefshme**
- **diploma**
- **cv**

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe ligjin 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, dhe zërat e punimeve qe parashikohen te behen. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Inxhinieret janë përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Prania e stafit teknik per afat te caktuar ne listepagesa i verteton AK se operatori ekonomik ka nje staf te qendrueshem, operativ i cili do te kryeje punimet ne kohe dhe me cilesi.

Shënim: Per kete procedure kemi rindertimin e 3 qendrave shendetesore si dhe rikonstruksionin e dy qendrave shendetesore, ne total 5 qendra shendetesore me vendodhje te ndryshme, prandaj jane kerkuar te pakten 2 Ing.Ndertimi.

2.3.4. Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës si më poshtë:

- Inxhinier Ndertimi 2 (dy)
- Inxhinier Elektronik 1 (nje)

Operatori ekonomik per Stafin mbeshtetes duhet te paraqese kontratat e punes te vlefshme, Diplome, CV, si dhe te jene ne listepagesat e shoqerise per te pakten **per periudhen Korrik – Shtator 2022**.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ligjin 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për stafin mbeshtetes, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates. Nevoja për stafin mbeshtetes në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Stafi mbeshtetes është

përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin të punimeve.

Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Inxhinierë ndertimi janë kërkuar 2 pasi nevojiten për të ndare punën në grupe ku detyra e tyre është organizimi i punës, kontrolli dhe dokumentimi i punimeve në objekt, ndjekja hap pas hapi e securesë së punimeve si dhe mbrojen e mjedisit dhe sigurisë në punë.

Shënim: Per kete procedure kemi rindertimin e 3 qendrave shëndetsore si dhe rikonstruksionin e dy qendrave shëndetsore, në total 5 qendra shëndetsore me vendodhje të ndryshme, prandaj janë kërkuar të pakten 2 Ing.Ndertimi.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- **1 (një)** punonjës përgjegjës Inxhinier, pjesë e stafit të shoqërisë, duhet të jetë i pajisur me certifikatën e Trajnimit për **"Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në Punë"**, e dhënë nga një organizim i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Diplome/certificate si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë.
- **1 (një) punonjës "Ekspert për ndihmën e parë dhe nderhyrjen nga emergjencat"**, e cila të jetë e leshuar nga shoqëria të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, certificate trajnimi si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë.
- **1 (një) punonjës** i pajisur me Çertifikatë **"Auditues Energjie"** të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, certificate trajnimi si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë.
- **1 (një) person** që përmbush kriteret për të qenë **"Ekspert Zjarrefikes"** i pajisur me Licence I.2.A ose kompania të jetë e pajisur me Licence I.2.A, në përputhje me pikën 4, në nenin 49, të Ligjit nr.152/2015 datë 21.12.2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certificate si dhe duhet të figurojë në listpagesat e shoqërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështet në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, si dhe ligjin 8402 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndertimit" datë 10.09.1998 i ndryshuar, ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier" si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", ligjit nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", të Ligjit nr.124/2015 "Për efikasitetin e energjisë".

Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës

për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjes së shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Operatori/ët ekonomik/ë, që gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të ketë/në kualifikimet dhe dokumentat përkatëse lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste ndotjesh siç parashikon VKM-ja nr.312/2010. Rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit janë detyrim ligjor për çdo subjekt tregtar person fizik apo juridik për parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

Ekspertet zjarrfikës janë te nevojshem për të arritur synimin, pasi referuar ligjir nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, roli i ekspertit zjarrfikës është në përpjesëtim me natyrën e kontratës.

Ligji nr.124/2015 “Për efincencën e energjisë” përcakton se “Auditim energjistik” është procedura që ndiqet për mbledhjen e të dhënave të nevojshme për profilin ekzistues të konsumit të energjisë së një ndërtese ose një grupi ndërtesash, të një objekti dhe/se instalimi privat, me qëllim identifikimin dhe përlllogaritjen e kostove dhe kursimeve të energjisë, raportimin e rezultateve dhe evidentimin e masave që duhen marrë në funksion të përmirësimit të efincencës së energjisë. “Përmirësimi i efincencës së energjisë” është rritja e efincencës në përdorimin fundor të energjisë, si rezultat i ndryshimeve teknologjike dhe /ose 8 sjelljeve ekonomike. Auditimet energjitike të detyrueshme kryhen: b) çdo herë përpara se një ndërtesë , objekt industrial dhe objekte të tjera që vlerësohen, vihen në punë dhe/ose ndërtohen nga e para apo i nënshtrohen një rinovimi të konsiderueshëm. operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi të ketë një auditues energjie me qëllim mbledhjen e të dhënave të nevojshme për konsumin e energjisë në objektin që do rikonstruktohet, identifikimin dhe evidentimin e masave që duhen marrë në funksion të përmirësimit të efincencës së energjisë.

Në nenin 9 pika 1 të ligjit nr.124/2015 “Për efincencën e energjisë” parashikohet se: “Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, përfshin në rregullat e prokurimit publik parashikime, të cilat detyrojnë autoritetet kontraktore që të përcaktojnë në dokumentet e procedurave të prokurimit të pajisjeve apo produkteve që kanë një ndikim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në konsumin e energjisë, specifikime teknike, që përmbushin kërkesat minimale të efincencës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji”

2.3.6 Operatori ekonomik të ketë në stafin e punonjesve si me poshte:

- Teknik Ndertimi 1
- Elektracist – 2
- Hidraulik – 3
- Karpentier / Murator / Suvatues – 5

- Hekurthyes - 2
- Bojaxhi – 2
- Saldator - 1

Për punonjësit e mësipërm të paraqiten, kontratat te punës të vlefshme, diplome ose certifikate ose dëshmi kualifikimi, te cilat duhet te jene te leshuara nga Institucione publike/private te licensuara. Specialistet e mesiperme duhet te figurojne ne listepagesat e shoqerise.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme janë përcaktuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar gjithashtu duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj si dhe duke u mbështetur mbi përvojën e mëparshme që ka pasur Autoriteti Kontraktor në zhvillimin e procedurave me objekt të ngjashëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për t’u njohur me kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

2.3.7 Të ketë në stafin e punonjesve të pajisur me dëshmi aftesimi profesional nga Institucionet shtetërore si edhe patente perkatese per punojesit e meposhtem:

- **Shofer - 5**

- **Manovrator / Automakinist 5**

Për punonjësit e sipërpërmendur të paraqiten, dëshmite e aftesise profesionale per manovratorët dhe Automakinist, lejet e drejtimit per shoferet, si dhe kontratat te punës të vlefshme. Specialistet e mesiperme duhet te figurojne ne listepagesat e shoqerise ose të kontraktuar.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme janë përcaktuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktojë **Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt**, i cili duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar ne kontrata te tjera dhe do te jete i pranishem gjate gjithë kohes qe do te kryhen punimet ne objekt. Bashkelidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet; Kontrata e punës e vlefshme dhe Diploma.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ne nenin 39, pika 6, gërma c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Eshte vendosur ky kriter duke u bazuar ne ligjin 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar, pasi cdo objekt zbatimi duhet te kete drejtuesin e saj teknik i

cili ushtron detyrat e tij ne perputhje me kete ligj dhe vendim Nr.312, datë 5.5.2010 ”Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”.

2.3.9 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtoresh prej minimalisht **100 (njëqind)** punonjesh, për periudhën **Korrik – Shtator 2022** e vertetuar kjo me:

- a) Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj.
- b) Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Vendosja e këtij kriteri për fuqinë punëtore duke qene se nuk nuk kemi nje preventiv perfundimtar eshte bere bazuar ne vlerën e kontratës qe prokurohet (rreth 40% e vleres e perben puntoria), afatit kohor per kryerjen e punimeve prej 12 (dymbëdhjetë) muaj i cili kerkon fuqi punetore dhe mjete per zbatimin me sukses te kesaj kontrate si dhe referuar pages mesatare per nje punonjesh.

Sa me siper për realizimin e kesaj kontrate nevojiten mesatarisht **100 (njëqind)** punonjesh.

Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje për periudhën **Korrik – Shtator 2022**, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpigjet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës.

2.3.10 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues, me kapacitet mbajtes mbi 18 ton	në pronësi ose me qira	Copë 3
2	Kamion vetëshkarkues, me kapacitet mbajtes 10-15 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
3	Kamionçinë me kapacitet mbajtes 3 - 5 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
4	Kamion me vinç	në pronësi ose me qira	Copë 3
5	Auvinc me Kosh	në pronësi ose me qira	Copë 1

6	Fadrome me goma me targa	në pronësi ose me qira	Copë 2
7	Eskavator me goma me targa	në pronësi ose me qira	Copë 1
8	Eskavator me zinxhire dhe cekic per prishje	në pronësi ose me qira	Copë 2
9	Minieskavator me zinxhir	në pronësi ose me qira	Copë 1
10	Minifadrome/ Bobcat ose eiukuvalent	në pronësi ose me qira	Copë 1
11	Autobot uji	në pronësi ose me qira	Copë 2
12	Autobetoniere	në pronësi ose me qira	Copë 4
13	Autopompe Betoni	në pronësi ose me qira	Copë 2
14	Pompe penobetoni	në pronësi ose me qira	Copë 1
15	Vibrator betoni	në pronësi ose me qira	Copë 2
16	Pompa suvatimi	në pronësi ose me qira	Copë 3
17	Tranxhe per prerjen e kthimin e hekurit	në pronësi ose me qira	Copë 1
18	Armatura druri (betoforma/lend drusore)	në pronësi ose me qira	2000m2
19	Betoniere	në pronësi ose me qira	Cope 1
20	Elektrosaldatrice	në pronësi ose me qira	Cope 1
21	Impiant prodhim betoni me QKL	në pronësi ose me qira ose me kontrate furnizimi	Cope 1
22	Impiant prodhim inertesh me QKL	në pronësi ose me qira ose me kontrate furnizimi	Cope 1
23	Depozite Uji 1000L	në pronësi ose me qira	Cope 2
24	Pompa Uji	në pronësi ose me qira	Copë 2
25	Skela 2000m2	në pronësi ose me qira	2000m2
26	Gjenerator	në pronësi ose me qira	Cope 2
27	Autovinc me kapacitet ngrites > 35 ton	në pronësi ose me qira	Cope 1

A. Per te deshmuar kete, Formulari i shtojces 13 te DST duhet te shoqerohet me dokumentat e meposhtme:

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërtetojnë pronësinë e mjetit:
 - certifikatën e pronësisë;
 - leja e qarkullimit;
 - certifikatën e kontrollit teknik;
 - siguracionin;
 - leja e transportit dhe fotot përkatëse ku të duket qarte targa dhe shërbimi i tij;
ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesipër, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerës e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të punimeve deri në perfundimin e plotë të punimeve.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot ku të duket qarte dhe shërbimi i tij ose fatura tatimore përkatëse, ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesipër, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerës e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të punimeve deri në perfundimin e plotë të punimeve.
- Për mjetet dhe pajisjet e tjera që nuk pajisen me leje qarkullimi, ofertuesi duhet të paraqesë kontratë notoriale të blerjes ose fatura tatimore të blerjes ose dokument zhdoganimi të mjetit.

B. Deklaratë me shkrim nga administratori i shoqërisë mbi vendodhjen e mjeteve.

C. Për impiantin e prodhimit të inerteve dhe betonit në Pronesi / Kontrate Qeraje, Kontrate Qeraje ose Furnizimi si dhe të jenë të pajisur me leje mjedisore, nga QKL si më poshtë:

- QKL Leje mjedisi Kodi III.1.B “Për impiant inertesh”.
- QKL Leje mjedisi Kodi III.1.B “Për impiant betoni, prodhimin e produkteve të betonit”.

D. Makinerite e mesiperme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera. Për këto të paraqitet një deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese se makinerite e mesiperme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruar në kontrata të tjera.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet dhe pajisjet, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, pajisjeve në pronesi / qera janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mesiperme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

2.3.11. Operatori ekonomik duhet të ketë kontratë notoriale me një laborator testimi të betonit, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar sipas standardeve SSH ISO/IEC 17025:2017 “Kërkesa të përgjithshme për kompetencën e laboratoreve testues dhe kalibruar”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme:

- ISO 9001:2015 (*Sistemi i menaxhimit të cilësisë*) ose ekuivalent të vlefshme të akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë

- ISO 14001:2015 (*Sistemi i menaxhimit të mjedisit*) ose ekuivalent e vlefshme te akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë .
- ISO 45001-2018 (*Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë*) ose ekuivalent e vlefshme te akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rast bashkimi operatorësh ekonomik, secili prej tyre duhet te jete i pajisur me certifikatat e siperpermendura.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

2.4.2 Operatori ekonomik duhet te kete licence QKL Kodi III.2.B “Grumbullimin, transportimin e mbetjeve.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.4.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/kontrate bashkepunimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje/mallra në këtë procedurë prokurimi, si më poshtë.

- Hekur;
- Hidroizoluese;
- Bojra hidroplastike;
- Pllaka;
- Polisteror;
- Grafiato;

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë

ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.4.4. Grafiku i punimeve, Preventivi. (Do paraqiten ne fazen e II).

Shënim: Operatori ekonomik kur te paraqese grafikun e punimeve ne fazen e II, duhet te percaktoje afatin per realizimin e projektit/projekteve + afatin per realizimin e punimeve brenda afatit qe ka kerkuar AK (12 muaj).

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:

Lidhur me realizimin e kesaj kontrate AK i ka shprehur qarte ne detyren e projektimit te gjithë proceset e punes qe kerkon te realizoje si kerkesat per cilesine e te gjithë punimeve dhe materialeve qe do te perdoren per realizimin me sukses te kontrates.

Ne specifikimet teknike qe jane hedhur ne dokumentet teknike te tenderit nuk eshte përmendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve.

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i proçedurave ligjore të prokurimit.

NJËSIA E PROKURIMIT:

- | | |
|-----------------|---------|
| 1. Pjeter Bushi | Kryetar |
| 2. Benard Palaj | Anëtar |
| 3. Elvis Guraj | Anëtar |